REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, SHËNDETËSORE DHE STREHIMIT
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Nr. Prot. **Bilisht më, . .2025**

PROJEKT-VENDIM
NR. 4, DATË 21/01/2025

"PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË STREHIMIT PER VITIN 2025"

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54 shkronja "k", nenit 55, pika 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" I ndryhsuar , të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", nenit 2 pika 51, nenit 15, pika 5, të ligjit nr. 22/2018, "Për Strehimin Social" i ndryshuar;

PROPOZOJ:

1. Të ngrihet dhe funksionoje pranë Bashkisë Devoll, Komisioni i Strehimit.
2. Komisioni i Strehimit shqyrton dhe merr vendime ne lidhje me kërkesat e paraqitur nga çdo subjekt që kërkon për të përfituar nga njëri prej programeve sociale të strehimit, si dhe për çdo çështje tjetër që parashikohet nga legjislacioni për strehimin, çështje sociale apo nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore që përcaktojne shqyrtimin e kërkesave nga ky komision.
3. Komisioni i Strehimit ka përbërjen e mëposhtme:

- Drejtor i Shërbimit Social - Kryetar komisioni.
- Drejtor i Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit -Anëtar komisioni
- Përgjegjës i Sektorit të Kujdesit Social dhe PAK -Anëtar komisioni.
- Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit - Anëtar komisioni.
- Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve - Anëtar komisioni.
- Përgjegjës i Emergjencave Civile - Anëtar komisioni
- Specialist i administrimit për nevojat për Strehim - Anëtar komisioni
- Përfaqësues nga Shoqata e Romëve - Anëtar komisioni.

4. Komisioni i Strehimit asistohet nga një sekretariat administrativ, i cili asiston komisionin gjatë gjithë veprimtarisë së tij. Anëtarët e sekretariatit janë pjesë e Drejtorisë së Shërbimit Social dhe janë përgjegjës për:

a.Marrjen në dorëzim të aplikimeve dhe kërkesave që janë objekt i shqyrtimit dhe vendimarrjes së Komisionit;

b.Shpërndan dhe vë në dispozicion të anëtarve, materialet për mbledhjet e radhës, brenda 5 ditëve punë para datës së mbledhjes;
c.Njofton Kryetarin e komisionit për çdo kërkesë të paraqitur për shqyrtim dhe u njofton anëtarve datën e marrjes në shqyrtim të kërkesës/aplikimit;
d.Dhënien e mendimit kur i kërkohet nga komisioni, mendim i cili pasyrohet në procesverbalin e mbledhjes;
e.Mban, harton, dhe nënshkruan procesverbanlin e mbledhjes;
f.Zbardh vendimin e arsyetuar të marrë në mbledhjen e Komisionit;
h.Çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga kryetari apo komisioni i strehimit;
5.Ngarkohet Sektori i Kujdesit Social dhe PAK të kryej procedurat përkatëse për përzgjedhjen e anëtarit nga komunitetet e interesuara që duhet të jenë pjesë e këtij komisioni.
6.Ngarkohet Kryetari i Bashkisë të miratojë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këtij komisioni.
7.Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Komisioni i Strehimit, Sektori i Kujdesit Social dhe PAK, për zbatimin e këtij vendimi.
8.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

Konceptoi: Specialiste për administrimin e nevojave për strehim
Linda Laçi
Konfirmoi: Përgjegjës i sektorit të Kujdesit Social
Marilda Bejleri
Miratoi: Drejtor i Shërbimeve Sociale, Shëndetësore dhe Strehimit
Zerina Sinani
Konfirmoi bazen ligjore:
Përgjegjëse e Sektorit Juridik
Eriksela Avdo

KRYETARI I BASHKISË
Eduard Duro

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, SHËNDETËSORE DHE STREHIMIT
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Nr. 209 **Prot.** **Bilisht më,** 21.10 **.2025**

RELACION

PËR PROJEKT- VENDIMIN

"PER NGRITJEN E KOMISIONIT TE STREHIMIT"

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" ndryshuar nenit 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika 1.1/b, neni 24, të ligjit Nr.22/2018 datë 03.05.2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar, neni 2 pika 51, VKM Nr. 362 datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënjes së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", VKM Nr. 384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit, për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore", VKM Nr.522 datë 25.07.2019 "Për metodikën e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira", VKM Nr. 301 datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit si dhe kushtet e standarte për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët", Udhëzimit Nr. 23 datë 30.12.2008 "Për përmbajtjen e bonusit të strehimit", si dhe VKB Nr. 69 datë 27.12.2024 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2025", propozohet miratimi i komisionit te strehimit."Komisioni i strehimit" është Komisioni që ngrihet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe ka në përbërje përfaqësues të komuniteteve të interesuar. Komisioni i Strehimit asistohet nga një sekretariat administrativ, i cili asiston komisionin gjatë gjithë veprimtarisë së tij. Anëtarët e sekretariatit janë përgjegjës për:

a. Marrjen në dorëzim të aplikimeve dhe kërkesave që janë objekt i shqyrtimit dhe vendimmarrjes së Komisionit;
b. Shpërndan dhe vë në dispozicion të anëtarëve, materialet për mbledhjen e radhës, brenda 5 ditëve pune para datës së mbledhjes;
c. Njofton Kryetarin e komisionit për çdo kërkesë të paraqitur për shqyrtim dhe u njofton anëtarëve datën e marrjes në shqyrtim të kërkesës/aplikimit;
d. Dhënien e mendimit kur i kërkohet nga komisioni, mendim i cili pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes;
e. Mban, harton dhe nënshkruan procesverbalin e mbledhjes;
f. Zbardh vendimin e arsyetuar të marrë në mbledhjen e Komisionit;
g. Ruan konfidencialitetin.
h. Çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga Kryetari apo komisioni strehimit.

Përgjegjës i Sektorit të Kujdesit Social dhe PAK

Marilda Bejleri

Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9; Tel+35581122288; E-mail: ***bashkiadevoll@gmail.com****; web:*